



REPubLIKA E SHQIPËRISË  
PRESIDENTI

**DEKRET  
PËR  
KTHIMIN E LIGJIT NR. 8893, DATË 14.05.2002 “PËR DISA  
SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8269, DATË 23.12.1997  
“PËR BANKËN E SHQIPËRISË” NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.  
8384, DATË 29.07.1998”.**


Në mbështetje të nenit 85, pika 1, të Kushtetutës,

***DEKRETOJ***

Kthimin për rishqyrtim edhe një herë në Kuvend të ligjit nr. 8893, datë 14.05.2002, “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” ndryshuar me ligjin nr. 8384, datë 29.07.1998”.

Tiranë, më 03.06.2002  
Nr. i dekretit: 3358

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS  
REXHEP MEIDANI**





REPUBLICA E SHQIPËRISË  
PRESIDENTI

**MOTIVIMI I KTHIMIT TË LIGJIT NR. 8893, DATË 14.05.2002, "PËR DISA  
SHTESA E NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8269, DATË 23.12.1997 "PËR  
BANKËN E SHQIPËRISË" NDRYSHUAR ME LIGJIN NR. 8384, DATË  
29.07.1998"**

Të nderuar deputetë!

Ligjin nr. 8893, datë 14.05.2002 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" ndryshuar me ligjin nr. 8384, datë 29.07.1998" vendosa të mos e shpall por ta kthej edhe njëherë për rishqyrtim në Kuvend, me synimin e përmirësimit të tij dhe të harmonizimit të tij me parimet kushtetuese.

Në ligjin 8269, datë 23.12.1997, neni 46 i tij, shpreh se "Funksioni i anëtarit të Këshillit Mbikqyrës është i papajtueshëm me atë të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, të deputetit në Kuvendin Popullor apo të anëtarit të Këshillit të Ministrave". Ky nen evidenton dhe garanton nga pikëpamja politiko – legjislative pavarësinë e Bankës së Shqipërisë në zhvillimin e politikës së saj monetare.

Ndërsa, amendamenti i shprehur në nenin 6, të ligjit nr 8893, datë 14.05.2002, me të drejtë synon shmangien e konfliktit të interesave.

Duke i konsideruar të dy prirjet e shprehura në ligj apo në amendament si të domosdoshme në trajtën e tyre eksplicite, pavarësisht kufizimeve ekzistuese në kushtetutë për Presidentin apo në sistemin rregullatoro – ligjor për institucionet e tjera, mendoj që neni 6 të ndryshohet si vijon:

"Në nenin 46, pas paragrafit ekzistues, shtohet paragrafi "Funksioni i anëtarit të Këshillit Mbikqyrës është i papajtueshëm me atë të punonjësit, administratorit dhe aksionerit, me pjesëmarrje ndikuese në bankën e nivelit të dytë ose në subjektet që licensohen nga Banka e Shqipërisë".

Duke shpresuar në mirëkuptimin Tuaj,

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS  
REXHEP MEIDANI**